

V E N D I M
Nr. 352, datë 28.7.1999

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 204,
26.3.1998 “PËR KOMPETENCAT, DETYRAT FUNKSIONALE DHE FINANCIMIN E
PUSHTETIT LOKAL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, me propozimin e Ministrisë së Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 204, datë 26.3.1998, bëhen këto ndryshime:

a) Në aneksin 1, pika I/3, shkronja “b) ambulancat dhe klinikat e shërbimit ambulator” zëvendësohet me shkronjën “b) qendra shëndetësore dhe ambulancat e fshatrave”.

b) Në aneksin 2 lidhja I pika 2, hiqet paragrafi i parë “investimet dhe administrimi i rrjetit ujitës në rastet kur burimet ujore brenda/afër fshatrave/qyteteve të komunës/ bashkisë dhe rrjeti i shërben vetëm një komune ose bashkie”. Hiqet paragrafi i katërt “Ndërtimi, mirëmbajtja dhe administrimi i kanaleve kulluese dhe ujitëse të treta, në rastet kur rrjeti i tyre është ndarë nga sistemi në shkallë rrethi dhe është brenda territorit të komunës.”

c) Në aneksin 2 lidhja II pika 5 “Bujqësia” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko